




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

19.02.18
OLSI VANGU



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 230/4 prot.

Vlorë, më 15.02.2018

VENDIM

Nr. 10, datë 14.02.2018

PËR

PROPOZIMIN E NUMRIT TË PERSONELIT TË TË GJITHA NIVELEVE NË
UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË

Në mbështetje të shkronjës ç, pika 1, neni 38 të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kerkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në Vendimin e Senatit Akademik nr.3 datë 01.02.2018 "Për përcaktimin e kategorive të personelit ndihmësakademik dhe personelit administrativ", si dhe në vendimin e Bordit të Administrimit nr. 2 datë 09.02.2018 "Për përcaktimin e kategorive të personelit administrativ", në funksion të Strukturës së përgjithshme të institucionit, Senati Akademik në mbledhje të datës 14.02.2018

VENDOSI:

1. T'i propozojë Bordit të Administrimit që numri i personelit me angazhim me kohë të plotë në të gjitha nivelet në Universitetin "Ismael Qemali", Vlorë, për të cilin është marrë në konsideratë struktura e deritanishme dhe aktiviteti i saj, të jetë **394** (treqind e nëntëdhjetë e katër), i shpërndarë si më poshtë:
 - a) Numri i personelit akademik me angazhim me kohë të plotë – **280 (dyqind e tetëdhjetë)**
 - b) Numri i personelit ndihmësakademik me karakter administrativ në nivel institucioni – **41 (dyzet e një)**
 - c) Numri i personelit ndihmësakademik me karakter administrativ në nivel njësie kryesore – **21 (njëzet e një)**
 - d) Numri i personelit ndihmësakademik me karakter administrativ në nivel njësie bazë – **2 (dy)**
 - e) Numri i personelit ndihmësakademik me karakter mësimor në nivel njësie bazë – **15 (pesëmbëdhjet)**
 - f) Numri i personelit administrativ në nivel institucioni – **35 (tridhjetë e pesë)**
 - g) Numri i personelit akademik me angazhim me kohë të pjesshme / personel akademik i ftuar – **120 (njëqind e njëzet)**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
SENATI AKADEMIK

2. Vendimet e SA-së me nr. 8, datë 26.01.2017, nr.18, datë 03.02.2017 dhe nr. 81, datë 18.07.2017, si dhe çdo akt tjetër i brendshëm i UV-së që bie ndesh me këtë vendim shfuqizohen.
3. Vendimi i përcillet Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI

